



09.06.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
DOKUMENTI ËSHTË NE DORËZIM		PRIMLJENO - RECEIVED	
Org. / Instituciona Unit	Numri / Braj Number	Shtojca / Filog Appendix	Vlera / Vendosje Value
01	016	34376	€

MEMORANDUM MIRËKËPTIMI DHE BASHKËPUNIMI NË MES TË AMERICAN ADVISING CENTER - EducationUSA KOSOVO DHE KOMUNËS SË SUHAREKËS

American Advising Center - EducationUSA Kosovo (AAC - EdUSA Kosovo) dhe Komuna Suharekës ("Komuna e Suharekës") të referuar së bashku këtu si "Partnerët," përmes këtij Memorandumi të Mirëkëptimi dhe Bashkëpunimi pajtohen që të krijojnë partneritetin për bashkëpunim të ndërsjellët për të rinjtë e Komunës. Specifikisht, ky bashkëpunim është për ofrimin, FALAS, të trajnimeve, punëtorive dhe sesioneve informuese për të rinjtë e Komunës së Suharekës për të studiuar në SHBA, me bursa - "Këshillim për studime në SHBA dhe bursa", Përgatitje për Testet Standardizuese TOEFL iBT & SAT dhe Programet JUNIOR COLLEGE PREP CLUB - jCPC - për nxënësit e klasave të 10-ta dhe COLLEGE PREP CLUB - për nxënësit e klasave të 11ta. Programi zgjatë pesëmbëdhjetë (15) muaj, nga Shtator 2022, dhe ka për qëllim përgatitjen e të rinjëve për të studiuar në SHBA, me bursa, të pjesëshme dhe/ose të plota. Programet janë hibride - kombinim i sesioneve virtuale dhe në American Advising Center, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, në Prishtinë.

Në mënyrë specifike, Komuna do të ofrojë mbështetjen si në vijim:

1. Të ndihmojë stafin e American Advising Center - EducationUSA Kosovo në promovimin e programeve, aktiviteteve dhe shërbimeve për të rinjtë nëpërmjet prezentimeve dhe info-sesioneve të organizuar në shkolla, qendra rinore, organizata, etj.
2. Të bashkëpunojnë me American Advising Center për shpërndarjen e materialeve të përgatitura/informatave dhe të identifikojë nxënësit potencial, të klasës së 10të dhe 11të, për programet JUNIOR COLLEGE PREP CLUB dhe COLLEGE PREP CLUB.
3. Të ofrojë hapësirë, falas, dhe përkrahje për ngjarjet dhe programet e American Advising Center- EdUSA Kosovo të cilat ndërlidhen me studimet në SHBA dhe mundësitë për shkëmbim edukativo arsmiore.
4. Të ofrojë përkrahje të përgjithshme stafit të American Advising Center - EducationUSA Kosovo dhe Ambasadës Amerikane në Kosovë për të mbikëqyrur, mirëmbajtur dhe monitoruar koleksionin e burimeve të ofruara si dhe shërbimet këshilluese me informata rreth arsimit universitar në SHBA.
5. Të siguroj që koleksioni dhe shërbimet e ofruara promovohen brenda shkollave të Komunës dhe që janë të hapura për të gjithë ata individë në Kosovë të cilët janë të interesuar të ndjekin studimet universitare në SHBA.
6. Të caktojë një person kontaktues përbrenda Komunës që do të shërbej si ndërlidhje në mes të American Advising Center - EducationUSA Kosovo dhe Komunës.



Në mënyrë specifike, American Advising Center - EducationUSA Kosovo do të ofrojë mbështetjen si në vijim:

1. Të ofrojë, falas, informata, prezentime dhe sesione informuese mbi studimet në SHBA, bursat akademike dhe testet standardizuese TOEFL dhe SAT në shkollat dhe organizatat rinore të Komunës së Suharekës.
2. Të ofrojë, falas, programin JUNIOR COLLEGE PREP CLUB - për një grup prej 25 nxënësve të klasave të 10-ta nga Komuna e Suharekës, të cilet kualifikohen
3. Të ofrojë, falas, programin COLLEGE PREP CLUB - për një grup prej 25 nxënësve të klasave të 11-ta nga Komuna e Suharekës, të cilet kualifikohen
4. Të ofrojë, këshillime dhe ndihmë për nxënësit të cilët dëshirojnë të studiojnë në SHBA, përgatitje për Testet Standardizuese në Gjuhën Angleze si TOEFL dhe SAT, përgatitje për CommonApp dhe CSS aplikacionet për studime dhe bursa
5. Të sigurojë materiale, kur janë të disponueshme, për programet dhe grantet e Qeverisë së SHBA-së, mundësi për edukim dhe mbështetje financiare në Shtetet e Bashkuara për shpërndarjen e tyre në Komunë.

Nënshkrimet

Palët si më poshtë kanë ekzekutuar këtë Marrëveshje Mirëkuptimi me: 09.06.2022

**Për American Advising Center –
EducationUSA Kosovo**



Rrezarta Fondaj

Për Komunën e Suharekës:

